

VENDIM
Nr.260, datë 3.10.2011

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT ME
PËRSËRITËS “RADIO ITALIA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira	Bushati	kryetare
Sami	Nezaj	zëvendëskryetar
Suela	Musta	anëtare
Alban	Karapici	anëtar
Gent	Ibrahimi	anëtar
Zylyftar	Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat me përsëritës “Radio Italia”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998
“Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,
VËREN SE:

Me vendimin nr.102, datë 23.7.2002, KKRT-ja ka licencuar subjektin “Albania Broadcasting System” sh.p.k. për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritës. Me vendimin nr. 471, datë 29.6.2006, këtij subjekti i është rinovuar licenca për një periudhë prej 4 vitesh. Në përfundim të afatit të licencimit, me shkresën nr.547 prot., datë 30.4.2010, KKRT-ja ka njoftuar subjektin për përfundimin e saj duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës. Meqenëse subjekti nuk kishte shfaqur interes, KKRT-ja, në mbledhjen e datës 28.3.2011, ra dakord që subjekti të njoftohet dhe t’i lihet përsëri në dispozicion një afat i ri 30-ditor për të depozituar kërkesën së bashku me dokumentacionin për rinovimin e licencës.

Pavarësisht njoftimit të dytë, nr.569 prot., datë 4.4.2011, rezulton se deri më tani, ky subjekt nuk ka paraqitur kërkesë apo aplikim për rinovimin e saj.

KKRT-ja konstaton se afati i vlefshmërisë së licencës së subjektit radiofonik privat me përsëritës “Radio Italia” ka përfunduar në datën 12.08.2010.

Gjithashtu, KKRT-ja vëren se subjekti me përsëritës “Radio Italia” ka detyrime financiare të pashlyera ndaj KKRT-së në vlerën 241.280 lekë, pasi nuk ka paguar taksën për licencë dhe taksën për shërbime rtv për vitet 2008-2009.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe nenit 33, pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.002/PPH, të subjektit radiofonik privat me përsëritës “Radio Italia”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati